



**UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

---

Ref. nr. 02/1388 Dt. 07.12.2016

---

**Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan**

**Rregullore për Kodin e Etikës në UKZ**

Gjilan  
Dhjetor, 2016



Në mbështetje të nenit 163 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit “Kadri Zeka”, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më 5.12.2016, duke u bazuar në propozimin e Senatit të Universitetit, nxjerr:

## ***RREGULLORE PËR KODIN E ETIKËS NË UKZ***

### **Neni 1 Qëllimi**

Kodi i Etikës ka për qëllim të vendosë rregulla të sjelljes së personelit akademik, administrativ dhe të studentëve, sipas rregullave dhe standardeve të vendosura në përputhje me frymën e etikës profesionale dhe morale të universitetit dhe me lirinë akademike. Kodi synon zhvillimin e kulturës brenda universitetit për të nxjerrë në dukje vlerat tona dhe ndërtimin e një etike bashkëkohore, bazuar në vlerat e pranuar bashkërisht, për të ndihmuar orientimin tonë në punë dhe për të rritur imazhin e universitetit.

### **Neni 2 Fushëveprimi**

Kodi i Etikës është i detyrueshëm për zbatim në Universitetin “Kadri Zeka”, duke përfshirë personelin akademik, punëtorët e administratës dhe studentët (në tekstin e mëtejme: anëtarët e universitetit) dhe të gjithë personat tjerë që në ndonjë formë a tjetër janë të lidhur me universitetin.

### **Neni 3 Emërtimet**

1. Plagjiatura nënkupton aktin e përvetësimit ose kopjimin e idesë, rezultateve, punimit të shkruar a të ndonjë forme tjetër në tërësi ose edhe pjesërisht, pa e treguar burimin e shfrytëzuar dhe pa pasur asnjë meritë për të njëjtat.
2. Autorësia e një vepre punimi shkencor ose profesional i nënshtrohet një rregulli rigoro etik: “Është pronësi, e cila as nuk mund të përvetësohet pa kontribut, por as të bartet te autorë të tjerë formalisht”. Të gjithë anëtarët e universitetit, të cilët marrin pjesë në punën kërkimore duhet të garantojnë burimin e të dhënave të publikuara dhe autorësinë e tyre, duke filluar nga ideja e veprës deri në dhënien e informacionit
3. Interesi privat i një anëtar të universitetit, jo vetëm i natyrës ekonomike, mund të lidhet me:
  - 3.1 interesin e drejtpërdrejtë të personit në cilësinë e tij si anëtar i universitetit, interesin e një anëtar të familjes së një anëtar të universitetit,
  - 3.2 interesin e institucioneve dhe kompanive, personave fizik dhe juridik me të cilët një anëtar i universitetit ka marrëdhënie pune apo raporte ekonomike;
  - 3.3 interesin e një institucioni, kompanie apo personi juridik, kur ai/ajo kontrollon nga një anëtar i universitetit apo kur ky posedon një pjesë të konsiderueshme financiare;

3.4 interesin e palës së tretë, kur përmes saj, një anëtar i të universitetit me qëllim i bëhen favore.

4. Të dhënat me statusin konfidenciale janë ato të dhëna të cilat janë të besuara për mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të universitetit dhe të cilat me ligj dhe me rregulloret e universitetit janë vlerësuar si konfidenciale.

5. Këshilli i etikës është një organ profesional i Senatit të Universitetit, i cili themelohet me propozim të rektorit dhe është kompetent për zbatimin e procedurave, në rastet kur shkelen rregullat e Kodit Etik nga mësimmshënësit dhe bashkëpunëtorët e universitetit.

6. Komisioni Disiplinor, është organ profesional i themeluar nga Këshilli i njësisve akademike të universitetit, i cili është kompetent për zbatimin e procedurave, në rastet kur bëhet shkelje e Kodit Etik nga ana e studentëve të universitetit.

#### **Neni 4**

#### **Të drejtat e garantuara universale**

1. Ky kod njih dhe mbron të drejtat e garantuara universale që janë pjesë e shoqërive demokratike.

2. Duke besuar se secili prej nesh është unik dhe ka vlerat e tij individuale, vlerat tona të përbashkëta konsiderohen që janë: ndershmëria, morali, respekti, përgjegjshmëria, përgjegjësia, drejtësia, korrektësia, solidariteti, objektiviteti, përkushtimi, transparenca, virtyti, toleranca.

#### **Neni 5**

#### **Respektimi i integritetit dhe dinjitetit të personelit të universitetit**

1. Anëtarët e universitetit janë të obliguar që të respektojnë integritetin dhe dinjitetin personal dhe profesional të secilit punëtor të universitetit.

2. Gjatë veprimeve të përditshme, çdo anëtar i universitetit duhet të jetë bashkëveprues, i komunikueshëm, të respektojë normat e edukatës qytetare, duke shmangur çdo sjellje apo veprim mospërfillës apo arrogant.

3. Anëtarët e universitetit janë të obliguar që të kontribuojnë në krijimin e atmosferës demokratike, tolerancës dhe vlerave të kulturës.

#### **Neni 6**

#### **Parimi i autonomisë në universitet**

1. Anëtarët e universitetit janë të obliguar që të ruajnë pavarësinë e vet si vlerë themelore të punës shkencore dhe t'i kundërvihen çdo përpjekjeje që vjen jashtë universitetit për imponim të vlerësimeve dhe kritereve që s'kanë të bëjnë me qëllimin dhe thirrjen e së vërtetës shkencore dhe rregullave profesionale.

#### **Neni 7**

#### **Parimi i efikasitetit**

Personeli akademik dhe administrativ duhet të organizojë punën e vet të përditshme me efikasitet.

## **Neni 8**

### **Parimi i konkurrencës së drejtë**

1. Anëtarët e universitetit, asnjëherë, nuk duhet të prononcohen apo të përcjellin një informacion të pasaktë me paragjykim, me qëllim dobësimi ose dëmtimi të reputacionit të konkurrencës së ndershme në universitet.

## **Neni 9**

### **Parimi i lirisë akademike në procesin mësimor dhe në punën kërkimore shkencore dhe profesionale.**

1. Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan promovon lirinë dhe autonominë individuale si parakusht për studim, mësim, profesionalizëm, kërkime profesionale dhe shkencore gjithëpërfshirëse dhe kërkesën për njohuri.
2. Anëtarët e universitetit duhet të sillen me ndershmëri dhe me përgjegjësi gjatë ushtrimit të lirisë akademike, në mënyrë që metodat, rezultatet, integritetin dhe implikimet etike të kërkimit t'ua paraqesin komunitetit shkencor dhe shoqërisë.
3. Anëtarët e universitetit do të respektojnë dhe zbatojnë vendimet akademike dhe ato të administratës të cilat i shërbejnë efikasitetit, barazisë, paanshmërisë dhe transparencës së veprimtarive institucionale të Universitetit.

## **Neni 10**

### **Parimi i profesionalizimit**

Nga anëtarët e universitetit pritet që, në mënyre profesionale dhe etike, t'i përmbushin të drejtat dhe obligimet në lidhje me procesin mësimor, në harmoni me parimet etike të kodit.

## **Neni 11**

### **Parimi i respektimit të ligjeve dhe rregulloreve**

Çdo anëtar i universitetit është i detyruar të punojë, studiojë dhe veprojë në përputhje me parimet kushtetuese, ligjet përkatëse, aktet nënligjore, Statutin, kodet, rregulloret dhe aktet e tjera të institucionit.

## **Neni 12**

### **Parimi i ndalimit të diskriminimit dhe ngacmimit**

1. Universiteti duhet t'u japë mundësi të barabarta çdo personi gjatë procesit të rekrutimit, emërimit, promovimit, pagesave, trajnimeve dhe praktikave të tjera të zbatuara në universitet pa dallim gjinie, race, origjine etnike, origjine kombëtare, ngjyre, besimi, dhe moshe.
2. I gjithë personeli i universitetit pritet të përshtatet me politikën antidiskriminuese të institucionit.

3. Për të nxitur një ambient respekti për dinjitetin dhe mirëqenien e çdokujt, prej anëtarëve të universitetit kërkohet angazhim për të krijuar një ambient pune pa asnjë lloj ngacmimi.
4. Ndalohet çdo veprim denigrues ndaj çdo anëtari të universitetit.
5. Komunikimet profesor-student, mundësisht kufizohen në hapësirat e Universitetit.

#### **Neni 13**

##### **Detyrimet në procesin mësimor**

Personeli akademik duhet që, gjatë punës së tij, të veprojë në pajtim me rregullat dhe detyrimet që dalin nga procesi mësimor.

#### **Neni 14**

##### **Praktikat e ndaluara në procesin mësimor**

1. Studentët u ndalohet përshkrimi apo kopjimi i çdo forme gjatë kryerjes së obligimeve që dalin në kuadër të procesit mësimor provime, detyra, seminare, si dhe me rastin kur ata i nënshtrohen vlerësimit të dijës ose njohurive.
2. Me kopjim nënkuptohet edhe pranimi ose dhënia e ndihmës, e cila ka ndikim në objektivitetin dhe korrektësinë e vlerësimit të punës së të punësuarve në universitet.
3. Të gjithë anëtarëve në universitet nuk u lejohet mbështetja ose çfarëdo ndihme që ka të bëjë me kopjimin.
4. Gjatë testeve të njohurive ndalohet përdorimi i telefonave dhe i mjeteve të tjera teknologjike.

#### **Neni 15**

##### **Shfrytëzimi i njerëzve në punën kërkimore shkencore dhe profesionale**

1. Nuk është i lejuar kërkimi, i cili mund të rezultojë me rrezikshmëri të lartë të lëndimeve fizike ose psikologjike, por edhe nëse të njëjtët kanë ndikim negativ në mjedis.
2. Nuk lejohet as mbështetja apo ndihma eventuale e anëtarëve tjerë të universitetit në këto aktivitete kërkimore me ndikime negative.
3. Gjatë kërkimit shkencor duhet të aplikohen parimet e marrëveshjeve reciproke të pjesëmarrësve në procesin e kërkimit shkencor. Të drejtat dhe dinjiteti i pjesëmarrësve në procesin e kërkimit shkencor duhet të mbrohen në mënyrë adekuate.
4. Nëse anëtarët e universitetit e zhvillojnë mësimin ose praktikën aty ku janë të pranishëm edhe fëmijët, atëherë, krahas parimeve të tjera, duhet të respektohen edhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve.

#### **Neni 16**

##### **Fabrikimi dhe falsifikimi i rezultateve**

1. Në punën kërkimore shkencore nuk lejohet fabrikimi dhe falsifikimi i të dhënave dhe rezultateve.
2. Fabrikimi i të dhënave a rezultateve gjatë fazave të caktuara të procesit kërkimor është lëndim shumë i rëndë i etikës shkencore. Me fabrikim mendohet në paraqitjen e trilluar të të dhënave që nga marrja e mostrave, aplikimin e metodave shkencore, shfrytëzimin e pajisjeve joadekuate, edhe pse është e njohur se kërkimi shkencor nuk i ka fituar ato të dhëna.

3. Falsifikimi nënkupton çdo veprim, i cili bie ndesh me parimet e etikës shkencore duke falsifikuar qëllimisht me rezultatet në të gjitha ose në një fazat e kërimit shkencor objektin, metodat, pajisjet dhe proceset.

#### **Neni 17**

##### **Plagjiatura**

1. Plagjiatura e çdo forme e punimeve dhe ideve është lëndimi më i madh i etikës shkencore dhe profesionale, pra i Kodit të Etikës.
2. Pandershmëri shkencore është edhe vetë plagjiatura, përsëritja e ideve, të dhënave dhe rezultateve, të cilat janë publikuar më herët nga i njëjti autor. Vetë plagjiaturë është edhe rasti kur informacioni i njëjtë botohet në revista të ndryshme shkencore, me qëllim që të rritet numri i punimeve të publikuara.

#### **Neni 18**

##### **Autorësia**

1. Nga anëtarët e punësuar në universitet, kërkohet që të vendosin si autorë vetëm ata persona që kanë marrë pjesë në procesin kërkimor dhe të cilët kanë dhënë kontribut intelektual në hartimin e veprës shkencore dhe profesionale.
2. Autor i një vepre shkencore dhe profesionale nuk mund të jenë personat, të cilët: vetëm e kanë financuar kërkimin; e kanë siguruar literaturën; janë vetëm drejtues të institucionit ku është kryer kërkimi shkencor; apo laborantët, të cilët kanë ndihmuar nga aspekti teknik, kolegët, miqtë, anëtarët e familjes etj.

#### **Neni 19**

##### **Falsifikimi dhe rirregullimi i rekomandimeve**

1. Falsifikimi dhe manipulimi i shkresave, rekomandimeve dhe dokumenteve zyrtare të universitetit, përdorimi i dokumenteve dhe të dhënave zyrtare të universitetit për qëllim keqinterpretimi, është lëndim i Kodit të Etikës.
2. Prezantimi jo i drejtë i të arriturave akademike në dokumente të shkruara ose mënyra të tjera të komunikimit, është i ndaluar dhe është shkelje e parimeve etike (zgjedhja në thirrje, formimi i komisioneve jo kompetente, pranimi i tezave të masterit dhe doktoratës pa bazë shkencore, paraqitja e thirrjes akademike dhe shkencore të cilën nuk e disponon.

#### **Neni 20**

##### **Pranimi i dhuratave**

Anëtarët e Universitetit nuk mund të kërkojnë apo pranojnë ndonjë dhuratë apo përfitim, qoftë edhe të natyrës simbolike, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi mund të ndikojë në aktivitetet e tyre në universitet. Vlera e saj nuk guxon të tejkalojë shumën njëzetë e pesë (25) Euro, ose zyrtari nuk mund të pranojë dhurata të rastit, vlera e përgjithshme e të cilave kalon mbi pesëqind (500) Euro brenda vitit.

#### **Neni 21**

##### **Konflikti i interesit**

1. Kur ndodh një konflikt i interesit, anëtari i universitetit duhet që menjëherë të informojë organin/personin kompetent dhe vetë të përmbahet nga zgjidhjet dhe vendimet.

2. Një konflikt i interesit ndodh kur interesi privat i një anëtari të universitetit, me përjashtim të studentëve, është në kundërshtim real ose potencial me interesat jo vetëm ekonomike e universitetit. Ky konflikt ka të bëjë edhe me raportet e punës në institucione arsimore apo universitete tjera dhe që konsiderohen si konkurrent potencial.

#### Neni 22

##### **Nepotizmi, favorizimet dhe keqpërdorimi i pozicionit personal**

1. Universiteti nuk toleron asnjë formë të nepotizmit dhe të favorizimit, sepse kjo është e papajtueshme me dinjitetin njerëzor, me njohjen e drejtë dhe të paanshme të mundësive dhe njohurive, ndershmërinë, integritetin, profesionalizmin, lirinë akademike, drejtësinë, paanësinë dhe transparencën. Universiteti kërkon nga profesorët, hulumtuesit dhe çdo anëtar tjetër të universitetit që të përmbahet nga një praktikë e tillë.

2. Nepotizëm është kur një profesor, një studiues, apo një anëtar i personelit teknik apo administrativ, drejtpërdrejt ose tërthorazi madje, edhe duke përdorur financimet e palës së tretë përdor reputacionin ose aftësinë e tij bindëse për të ofruar favore, për të përshatur shpalljet dhe kontratat e punës, për të ndikuar në rezultatet e konkurrencës apo procedurat e përzgjedhjes, veçanërisht, ato të cilat kanë të bëjnë me fillimin apo vazhdimin e karrierës universitare (kjo i prekë edhe bursat, kontratat, kontratat për asistentët hulumtues), si dhe pranimin e fëmijëve, pjesëtarët e familjeve dhe të afërmeve (në formën e bashkëjetesës dhe miqësisë).

3. Si nepotizëm konsiderohen edhe favorret e një profesori ndaj studentëve të tij. Kjo sjellje është e papajtueshme me vlerat e ndershmërisë dhe paanësisë, si dhe me interesat dhe karrierën e kandidatëve meritör.

4. Anëtarët e universitetit nuk mundën, direkt ose indirekt, të përdorin pozitën e tyre akademike ose zyrtare për të urdhëruar anëtarët e universitetit për të përfituar në të mirën e tyre, përveç nëse nuk është fjala për ndonjë detyrim ligjor ndaj tyre. Abuzimi, gjithashtu, ekziston kur sjellja nuk përbën një akt të paligjshëm, por ka papajtueshmëri të dukshme me frymën e rregullave dhe rregulloreve të universitetit.

#### Neni 23

##### **Transparenca dhe konfidencialiteti**

1. Universiteti promovon dhe mbështet transparencën dhe konfidencialitetin në dokumentet e tij dhe veprimtarinë e anëtarëve të tij, si një nga vlerat elementare.

1.1. Të gjithë anëtarët e universitetit duhet të respektojnë transparencën dhe qasjen në kriteret dhe metodat e vlerësimit gjatë punës profesionale regjistrimi, provimet, ngritja profesionale, etj.

2. Të gjithë anëtarët e universitetit, të cilët, në bazë të detyrave të punës, brenda universitetit disponojnë me të dhëna të cilat kanë statusin të *dhëna konfidenciale*, duhet të mundësojnë mbrojtjen e tyre.

#### Neni 24

##### **E drejta dhe obligimet për aftësimin e vazhduar dhe edukimin gjatë gjithë jetës**

Universiteti “Kadri Zeka” promovon dhe kërkon nga anëtarët e vet angazhim të vazhdueshëm pa marrë parasysh titullin shkencor apo statusin në fitimin e njohurive të reja shkencore dhe profesionale dhe të njëjtat t’ua përcjellin studentëve dhe vartësve të tyre.

## **Neni 25**

### **Ngritja profesionale**

1. Universiteti "Kadri Zeka" duhet t'i japë mundësi të barabarta çdo personi gjatë proceseve të ndryshme të rekrutimit, emërtimit, promovimit, trajnimit apo avancimit në universitet pa marrë parasysh fenë, gjininë, orientimin seksual, dukjen, ngjyrën e lëkurës, gjuhën, origjinën etnike dhe sociale, shtetësinë, situatën personale dhe gjendjen shëndetësore, shtatzëninë, moshën, si dhe pozitën e tij në kuadër të universitetit.
2. Detyra dhe obligimi i mësimdhënësve është që të angazhohet për përtëritjen e kuadrit kërkimor, artistik dhe mësimdhënës.

## **Neni 26**

### **Paraqitja publike**

1. Anëtarët e universitetit duhet të respektojnë emrin e mirë të universitetit dhe nuk guxojnë të dëmtojnë reputacionin e tij.
2. Anëtarët e universitetit nuk mund të përdorin pa autorizim emrin dhe logon e universitetit, gjatë paraqitjes publike.

## **Neni 27**

### **Përdorimi i burimeve të Universitetit**

1. Anëtarët e universitetit duhet të përdorin resurset e universitetit me përgjegjësi, kujdes dhe arsyeshëm, në atë mënyrë që shpenzimet e justifikuara dhe me kërkesë të universitetit të dëshmojnë përmes dokumenteve apo mbajtjes së llogarisë.
2. Pa lejen e qartë të universitetit, asnjë anëtar i të universitetit nuk i lejohej të përdorë objektet kërkimore, hapësirat, burimet njerëzore, materialet, hardware ose software, apo burimet financiare të universitetit, personalisht ose përmes lejimit të palëve të treta, personave apo institucioneve për qëllime personale ose për qëllime tjera nga ato institucionale të universitetit.

## **Neni 28**

### **Detyrat e Përgjithshme**

Të gjitha organet në njësitë akademike dhe ato të universitetit janë të obliguara që, secila, në kuadër të autorizimeve të tyre, të kujdeset për aplikimin dhe avancimin e standardeve etike në universitet dhe zbatimin e Kodit Etik.

## **Neni 29**

### **Përgjegjësia për shkeljen e Kodit të Etikës**

1. Mosrespektimi i parimeve të këtij kodi, gjegjësisht, shkelja e këtyre parimeve, paraqesin lëndimin e ndershmërisë dhe detyrave të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve, studentëve, personelit të administratës dhe të tjerëve të lidhur me universitetin, për të cilën, të njëjtit duhet të mbajnë përgjegjësi.
2. Zgjidhjen e denoncimeve ose raportimeve për shkeljen e Kodit Etik e bëjnë organet për zbatimin e Kodit Etik të universitetit.



### **Neni 30**

#### **Organet për zbatimin e Kodit të Etikës**

1. Organet, të cilat kanë kompetencë për zbatimin e Kodit Etik të universitetit, janë:
  - 1.1 Këshilli i Etikës, i cili zgjidhet nga Senati i Universitetit.
  - 1.2 Komisioni Disiplinor, i zgjedhur nga Këshilli i njësisë akademike të universitetit.
  - 1.3 Komisioni Disiplinor ad-hoc, i caktuar nga rektori i universitetit, gjegjësisht, nga dekani/drejtori i njësisë akademike të universitetit.

### **Neni 31**

#### **Këshilli i Etikës**

1. Këshillin e Etikës e përbëjnë: katër anëtarë nga njësitë akademike me mandat katër vjeçar dhe përfaqësuesi i Parlamentit të Studentëve me mandat 1 vjeçar.
2. Kryetari i Këshillit të Etikës zgjidhet nga anëtarët e Këshillit dhe ka mandat katër vjeçar.
3. Këshilli i Etikës mund të nxjerrë Rregulloren e punës, me të cilën do t'i rregullojë çështjet të cilat nuk janë paraparë me këtë Kod.

### **Neni 32**

#### **Komisioni Disiplinor**

1. Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre anëtarë: kryetari dhe një nga anëtarët zgjidhet nga radhët e stafit akademik ose bashkëpunëtorët e universitetit me mandat katër vjeçar, ndërsa, një anëtar nga organizatat e studentëve me mandat 1 vjeçar.

### **Neni 33**

#### **Komisioni Disiplinor ad-hoc**

Komisioni Disiplinor ad-hoc është organ, i cili themelohet me vendim të rektorit të universitetit, gjegjësisht, dekanit të njësisë akademike, i cili është kompetent për zbatimin e procedurave, në rastet kur Kodi Etik është shkelur nga të punësuarit jashtë procesit mësimor në Rektoratin e Universitetit, gjegjësisht në njësitë akademike të universitetit.

### **Neni 34**

#### **Fillimi i procedurave**

1. Procedurat për vërtetësinë e shkeljes së ndonjë parimi të Kodit Etik të Universitetit, mund të fillohen me dorëzimin e fletëparaqitjes për shkelje të Kodit, në formë të shkruar, te organet për zbatimin e Kodit, nga neni 31 i Kodit Etik.
2. Fletëparaqitjen për shkeljen e Kodit të Etikës mund ta dorëzojnë të gjithë të punësuarit, por e njëjta duhet të jetë e arsyetuar me të gjitha të dhënat dhe dëshmitë për personat, kohën, vendin, dëshmitarët eventuale dhe të jetë e nënshkruar nga bartësi i fletëparaqitjes.
3. Organi për zbatimin e Kodit Etik nga neni 31 i Kodit, nuk do t'i marrë në shqyrtim fletëparaqitjet anonime.

### **Neni 35**

#### **Procedurat e punës së Këshillit të Etikës dhe afatet**

1. Në bazë të fletëparaqitjes për shkeljet e parimeve etike nga mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët, sipas kritereve të nenit 34, kryetari i Këshillit të Etikës thërret

mblledhjen e Këshillit në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të fletëparaqitjes.

2. Nëse Këshilli i Etikës vërteton mosekzistimin e shkeljeve të parimeve nga ana e mësimit dhe bashkëpunëtorëve, me një vendim të saj e refuzon fletëparaqitjen si të pabazuar.

3. Nëse Këshilli i Etikës e vërteton se është bërë shkelje e ndonjë prej parimeve të Kodit Etik, ai me një vendim i propozon Senatit të Universitetit masën përkatëse e cila është: vërejtje me shkrim ose vërejtje publike. Në rast se, këto shkelje bëhen të përsëritura, Këshilli i Etikës i propozon autoritetit drejtues ndëshkime të tjera më të rrepta.

4. Për shkeljen e parimeve të Kodit të Etikës, sipas rastit, Këshilli i Etikës propozon masa disiplinore nga marrja e thirrjeve deri në largim nga puna.

5. Nëse Këshilli i Etikës e vërteton se shkeljet e ndonjë prej parimeve të Kodit të Etikës, nga mësimit dhe bashkëpunëtorët e universitetit, bien në kundërshtim me Ligjin e Punës dhe Statutin e Universitetit “Kadri Zeka”, ai i propozon masat në harmoni me Rregulloret e Punës së Universitetit dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë.

6. Vendimet në Këshillin e Etikës merren me shumicën e votave të anëtarëve të përgjithshëm.

### **Neni 36**

#### **Procedurat e Komisionit Disiplinor dhe afatet**

Procedurat e Komisionit Disiplinor, të themeluara nga njësitë akademike të universitetit, zbatohen në harmoni me rregullat e Statutit të Universitetit dhe aktet e tjera normative.

### **Neni 37**

#### **Procedurat e Komisionit Disiplinor ad-hoc dhe afatet**

1. Në bazë të fletëparaqitjes së dorëzuar rreth shkeljes së ndonjë prej parimeve të Kodit Etik nga personeli joakademik i universitetit (rektorati dhe njësitë akademike), komisioni i emëruar ad-hoc fillon procedurat për vërtetësinë e shkeljeve të parimeve etike të Kodit, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga data e marrjes së fletëparaqitjes.

2. Nëse Komisioni ad-hoc vërteton se nuk ka shkelje të parimeve të Kodit Etik të Universitetit, ai me një vendim e refuzon fletëparaqitjen si të pabazuar.

3. Nëse Komisioni ad-hoc vërteton se janë shkelur parimet etike të Kodit, atëherë i propozon rektorit/ dekanit/drejtorit, masat: vërejtje me shkrim, vërejtje publike.

4. Nëse Komisioni ad-hoc vërteton se janë shkelur parimet etike të Kodit Etik, të cilat bien në kundërshtim me Ligjin e Punës, Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Statutin e Universitetit, atëherë komisioni u propozon organeve përkatëse fillimin e procedurave disiplinore sipas akteve ligjore të lartpërmendura.

### **Neni 38**

#### **Vendimi i Senatit, rektorit apo dekanit**


1. Vendimi i Senatit të Universitetit i sjellë në bazë të propozimit të Këshillit të Etikës, për masën e propozuar nga neni 35 i Kodit të Etikës, është përfundimtar.

2. Vendimi i rektorit apo dekanit të fakultetit i sjellë në bazë të propozimit të Komisionit Disiplinor dhe Komisionit ad-hoc, për masën e propozuar nga neni 36 dhe neni 37 i Kodit të Etikës, është përfundimtar.

**Neni 39**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

1. Interpretimin e Kodit Etike bën Këshilli Drejtues i Universitetit.
2. Kodi Etik diskutohet nga ana e njësive akademike dhe Senatit para se të aprovohet nga Këshilli Drejtues.
3. Rektori i Universitetit duhet t'i propozojë Senatit për miratim listën e anëtarëve të Këshillit të Etikës, brenda tre muajsh nga dita e miratimit të këtij kodi.
4. Kodi Etik hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit dhe i njëjti lajmërohet në ueb-faqen e universitetit dhe bëhet publik për anëtarët e universitetit.



  
Akademik Fejzullah Krasniqi  
Kryesues i Këshillit Drejtues